




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUÇITRIN	
02 Nr. / Dr.	718-1/21
Nr. llog. / Br. sh.	-04
Data: / Datum	25.06.2021
VUSHTRRI - VUÇITRIN	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA VUSHTRRI

PROCESVERBAL

Nga Takimi Publik me Qytetarë

Takimi publik me qytetar u mbajt më dt. 25.06.2021 në ora 10.00 në Qendrën e Kulturës "Hasan Prishtina. Në takim morën pjesë z.Xhafer Tahiri - Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Drejtorë të Drejtorive Komunale stafi i zyrës së kryetarit gjithsej afër 156 qytetarë.

Takimin e hapi dhe e kryesoi Kryetari i Komunës, Xhafer Tahiri, i cili ju shprehu mirëseardhje qytetarëve dhe tha se për dallim prej vitit të kaluar ku ishim të detyruar që takimet tona ti mbajmë në distancë për shkak të pandemisë COVID-19, këtë vit fal Zotit dhe duke e falënderuar punën dhe angazhimin e pakursyer të stafit mjekësor bashkë me stafin e infermierëve u arrit që të ulet numri i rasteve, ndërsa në këta muaj të fundit kemi shpresën se do të kaloj ky virus, i cili la pasoja bukur të rënda në jetën dhe shëndetin e qytetarëve.

Me qëllim të zbutjes së pasojave nga kjo pandemi kemi marrë masa në suaza të kompetencave ligjore dhe mundësive buxhetore që të ndihmojmë me barna dhe pako ushqimore e higjienike të prekurit dhe familjet e tyre nga ky virus, kemi ndihmuar po ashtu bizneset e komunës duke iu nda mjete financiare të cilat sado pak e kanë lehtësuar punën dhe veprimtarinë e tyre me të cilën ata janë marrë.

Në vazhdim i njoftoj me realizimin e projekteve, punët që janë bërë nga Komuna e Vushtrrisë. Duke folur për të arriturat kryesore, ai tha se ky vit ka qenë vit i sfidave por edhe vit i realizimit të projekteve. Në raportimin e tij para qytetarëve të Vushtrrisë, kryetari Tahiri tha se është arritur sukses në menaxhimin e mbeturinave, ku kompania "Uniteti" po kryen shumë mirë shërbimet derë më derë, por edhe qytetarët po i kryejnë shumë mire obligimet sa i përket shërbimeve që po marrin. Po ashtu me gjithë problemet, ai tha se kanë arritur që të lidhen mbi 4900 familje në rrjetin e ujësjellësit. Ndërsa sa i përket arsimit, kryetari Tahiri tha se këtë vit janë ndarë gjithsej 69 bursa për studentë, për dallim prej viteve të kaluara ku janë ndarë vetëm 34 bursa. Po ashtu ai ka folur edhe për idenë e ndërtimit të Ngrohtores së qytetit, shtëpinë e qëndrimit ditor për pleqtë si dhe projekte tjera.

Ai tha se puna dhe angazhimi ynë gjatë këtij 6 mujori është bazuar në planet tona të punës, përkatësisht planifikimin buxhetorë të paraparë për këtë vit. Kemi filluar me realizimin e projekteve në bazë të prioriteteve përcaktuara, atyre projekteve dy apo tri vjeçare, të cilat kanë filluar vitin e kaluar për të vazhduar në këtë vit, e po ashtu edhe projektet e këtij viti, me qëllim të përmirësimit të kushteve të jetesës së qytetarëve.

Në vazhdim ai raportojo për buxhetin e vitit 2021, ku rritje më të madhe të të hyrave vetanake kemi te Tatimi në Pronë dhe te lejet

Tani i informoj për buxhetin e komunës për vitin 2021 planifikimin dhe realizimin e tij, për të vazhduar me punët që janë kryer dhe atyre që janë duke u kryer e do të kryhen brenda këtij viti.

Planifikimi i buxhetit për vitin 2021

- Paga dhe mëditje.....10,957,281.27 €
- Mallra dhe Shërbime.....3,839,413.94 €
- Shpenzime Komunale.....334,376.22 €
- Subvencione dhe Transfere.....987,304.93 €
- Investime Kapitale.....5,314,944.28 €

Nga muaji janar- deri më tani janë shpenzuar:

- Paga dhe mëditje.....4,423,921.94 €
- Mallra dhe shërbime.....1,225,810.4 €
- Shpenzime Komunale.....166,612.42 €
- Subvencione dhe Transfere.....304,240.75 €
- Investime kapitale.....526,841.46 €
- Totali i shpenzimeve.....6,647,426.97 €**

Realizimi i shpenzimeve është.....31.01%

Të hyrat vetanake të planifikuara për këtë vit janë.....1,906,903.00 €

Realizimi i të hyrave deri më tani është.....1,014,422.26 €

Nga ana tjetër megjithëse ka theksuar projektet që janë kryer, qytetarët kanë kërkuar projekte që kryesisht kanë të bëjnë me infrastrukturën.

Nga ana tjetër kryetari Tahiri duke ju përgjigjur interesimit të qytetarëve tha se duke ju dhënë prioritet kërkesave që kanë të bëjnë me interesin e përgjithshëm, do të zgjidhen çështjet e adresuara nga qytetarët.

Debati me qytetarë.

Gazmend Curri, fshati Reznik, kërkoj prioritetet për këtë fshat siç janë: shtruarja e rrugëve me zhavorr, rrjeti i kanalizimit dhe fusha sportive.

Salih Bajrami, fshati Mihaliq, i cili i paraqiti disa prioritete: ndriçimi i fshatit, kanalizimi, të bëhet linja e autobusit nga Rezniku në Prishtinë, sepse për të shkuar në Prishtinë duhet me ardhur njëherë në Vushtrri e tani në Prishtinë dhe anasjelltas, banorët po kanë shpenzime të mëdha dhe po humbin kohe. Rrugët janë rregulluar 97 %, nuk kemi mirëmbajtje të rrugëve kështu që po dëmtohen.

Gani Mehulli, fshati Akrashticë, ai tha se jeton në perëndim por përkohësisht gjendet këtu. Ju falënderoj shumë që ja keni kthyer krenarinë qytetit me Hasan Prishtinën dhe Ahmet Krasniqin. Problem paraqesin parkingjet, të ndalohet ndërtimi në fshatin Begaj. Vushtrria duhet të ketë një stacion të autobusëve.

Rrahim Zeka nga fshati Vërrnicë ka kërkuar që të rregullohet rruga në gjatësi prej 300 metrave, mirëpo prej 300 m. janë rregulluar vetëm 150 m. Si mundë të shtrohet rruga kurë shtyllat janë midis rrugë, nuk kam mundur me biseduar me juve edhe pse vëllai i dëshmorit nuk më keni marrë parasysh.

Ahmet Mustafa, fshati Smrekonicë, problem kryesor është ujësjellësi në këtë fshat, nuk kemi ujë, prej që është prishur rruga, problem tjetër janë mbeturinat në krye të rrugës, i djegin, nuk mundemi me i hapë dritaret. Kemi shkruar sa herë në faqen e juaj por nuk kemi marrë përgjigje.

Bislim Ismajli, fshati Gumnishtë, lagjja Ismajli ka mbetur pa u rregulluar Në këtë fshat ka banorë, ka bagëti, kërkesa kam bërë vazhdimisht prej 2007 tës.

Bratisllav Kostiq kryetar i Këshillit të fshatit Gojbulë, sikurse të gjithë edhe ne kemi probleme të ndryshme. Problemi i ujit, ujësjellësi ka pak ujë ka kërkuar që të rregullohet rruga dhe një pjesë e kanalizimit brenda fshatit. Asfalti është prishur dhe është rregulluar edhe më dobët që ka qenë, ka shumë balt. Ne e kemi kryer një projekt me USAID-in dhe nuk dimë çka u bë me te, kush i muarr paratë.

Ragip Bunjaku tha se me 12 janar të këtij viti është dëmtuar shumë nga vërshimet e lumit Sitnicë ku i janë shkaktuar dëme materiale në shtëpi por edhe dëme të mëdha në bagëti, ku uji i ka mbytur delet. Ai tha se që nga ajo kohë komuna e ka ndihmuar me 2460 euro për dëmet në shtëpi, komuniteti turk e kanë strehuar në banesa të zhegrovëve, tani është kthyer në shtëpinë e tij por ju ka ndërpre rryma nuk rregullohet, nuk vjen KEDS-i me rregulluar trafon por ende nuk ka marr asnjë kompensim nga Ministria e Bujqësisë për delet që i janë mbytur.

Ahmet Seferi fshati Shalë, ai tha se në atë fshat kanë qenë 1300 banorë, tash 650, sepse nuk ka infrastrukturë, vetëm tre vetë janë punësuar.

Strahinja Andriç, Prelluzhë, infrastruktura në këtë fshat tepër e rënduar, ku jetojnë 400 banorë. Kemi probleme të mëdha gjatë të reshurave atmosferike. Në shtëpi të kulturës të bëhet ndriçimi dhe zërimi.

Feriz Sadiku, fshati Gllavotin, problem është uji, skemi ujë, mandej çështja e pazgjedhur e varrezave.

Driton Kamberi, fshati Pantinë, e kam një kërkesë për lagjen Kamberi, gjatë të reshurave atmosferike rruga bëhet e pa kalueshme.

Sabri Avdulli, fshati Duboc, unë i kam tri kërkesa me rëmdësi, ujësjellësi, kanalizimi dhe rruga.

Nexhmedin Klinaku, fshati Bivolak.kanalizimi kundërmon erë të rëndë, ndriçimi dashtë zoti e të realizohet, rruga “Hilmi Saraqi të rregullohet. A ka mundësi rezervarit një rrethojë mos të hyn shiu.

Gëzim Jetullahu, fshati Vërnocë, trotuare nuk ka, fëmijët shkojnë në shkollë është problem.

Ridvan Perçuku, fshati Ceceli, ju përgëzoj për punën, kemi ndërmarr një iniciativë për ndërtimin e një lapidari, kushton mjaft shumë andaj kërkojë që të na ndihmoni, mandej të na mundësoni kanalizimin e ndriçimin.

Milazim Hyseni, Drejtor i shkollës fillore “Ali Kelmendi”, problemin do ta shtroj për këtë shkollë, pasi që për persona me nevoja të veçanta është vetëm një mësuese. Një gjë që më pëlqej kurë folët për performancë të komunës, kishte me qenë mirë që edhe shkollat me pasë performancë, pasi që kemi mungesë të mësimitdhënësve.

Ardian Hyseni, Vushtrri, dua ta falënderoj z.Gëzim Saraçin, për hapjen e bibliotekës ku lexoj, por kisha me propozu që kjo bibliotekë të punojë 6 ditë në javë.

Naim Ibishi, Fshati Druar, në QMF mjeku vjen shumë pak dy-tri orë, asnjëherë nuk rin me orar të plotë, objekti është i rregulluar mirë, por mjeku nuk rin. Mu ka lënduar djali nuk ka qenë mjeku edhe pse kjo ambulante është për disa fshatra.

Zekri Muzaqi, fshati Reznik, problemi që na mundon më së shumti është mungesa e kanalizimit.

Agron Pllana, Drejtor i shkollës në fsh. Shtitaricë, paraqiti këto kërkesa: rregullimi i rrethojës së oborrit të shkollës në këtë fshat, rregullimin e qatisë së shtëpisë së kulturës “Ramadan Fazliu”, rregullimi i dyshemesë së klasës për parashkollor, rregullimi i trotuarit nga qyteti deri në fsh. Shtitaricë.

Jeton Krasniqi, fshati Studime e Ulët. Nuk kam mundur me taku Shkëlzenin, nuk kemi as ndriçim as kanalizim, kurrfarë investimi nuk është bërë në këtë fshat, shtyllat i kemi kurë janë vendosur në kohën e Titës. Të gjitha instalimet i kemi me korrektorë.


Fidaim Asllani, Fshati Mihaliq, prej fundit të shkurtit na u ka ndalur uji, kemi edhe probleme tjera, nuk kemi kanalizim, kemi nevojë për parking.

Blerim Ibrahim, Vushtri, e falënderoj drejtorin e DSHP-së, që është duke e bërë një punë të shkëlqyeshme ndriçimin. I kam dy çështje: largimin e mbeturinave të Vigu që lidhë fshatrat sepse njerëzit nuk po vetëdijesohen, si dhe të rregullohet rruga kah vigu.

Xhafer Tahiri, tha se Drejtoria për Urbanizëm e ka bërë planin për një urë që do të lidhë fshatrat. Dy familje në Çyçavicë kanë nevojë për strehim. Në vazhdim ai tha se jam shumë i lumtur që shumë fshatra kanë ujë. Sa i përket kanalizimit e ndriçimit po mundohemi t'i përfshijmë të gjitha fshatrat, është kontratë dy vjeçare. Për transport është kërkesë me vendë, duhet të planifikojmë, sa ta bëjmë stacionin. Do t'i bëjmë dy stacione të autobusëve një stacion të madh në periferi dhe një të vogël në qytet. Dua ta falënderoj mërgimtarin. Ne do të dalim në teren për rrugën 300 m, e që është rregulluar vetëm 150 m. Ne e kemi të limituar buxhetin, por po mundohemi që më së pari ta rregullojmë punën e ujit. Sa i përket kërkesës së Bislim Ismajlit do të rregullohet ai problem. Në Smrekonicë ujësjellësi nuk ka shtypje por në secilën shtëpi ka ujë, por ata nuk e lëshojnë shtypjen. I kemi larguar 95 deponi të mbeturinave tani kemi vetëm 5 deponi, jemi komuna që kemi shqiptuar më së shumti gjoba, ju duhet të na ndihmoni duke fotografuar. Bratisllavin nga Gojbula e falënderoj shumë që ka ardhur dhe e ftojë në komunë të bëjmë zgjidhje. Sa i përket vërshimit z. Bunjakun e kemi lajmëruar 12 orë më parë, të cilit ja ka marrë uji 100 dele, mirëpo ai ka marrë 2460 €. Derisa e kemi këtë gjendje me lumin Sitnica, kështu e kemi, por duhet mos me ndërtuar afër lumit. Në atë moment që na qet ministria të hollat ne do t'ju shpërndajmë. Vërshimet kanë edhe dobi se e bëjnë tokën pjellore. Sa i përket shkollës "Vuk Karagjiq" edhe aty do të bëjmë riparimin. Feriz sadiku e paraqiti problemin e ujit dhe të varrezave. Për ujë jemi duke punuar kurse për varreza kemi marr vendim në kuvend. I përgjigjem Driton Kamberit jemi duke i trajtuar rrugët besoj që do ta trajtojmë edhe këte. Për kanalizim do të vendosim reduktorët, por kjo punë shkon ngadalë, është projekt dy vjeçar. Sa i përket trotuareve jemi duke shkuar fshat për fshat. Ridvanin e falënderoj për Ceceli, që e kanë marrë këtë iniciativë kaq të shtrenjtë. Ne e kemi hequr pagesën për parashkollor Milazim, do të vazhdojmë me investu me mësues ndihmës por mvaret sa na lejon ministria. Në Studime kam qenë në kontakt me donatorë. Për bibliotekë nuk do të ketë problem. Unë çdo ditë marr raport sa pacienta kanë qendrat e mjekësisë familjare. Rruga "Jeton Tërstena do të rregullohet, kam kërkuar një trafo do ta sjellin. Fidan Asllani besoj që do ta lëshojnë shtypjen e ujit më shumë.

Takimi publik përfundoi në ora 12.10.

Procesmbajtëse


Hadika Abdurrahmani


Kryetar i Komunës

Xhafer Tahiri